



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-7034/24
Kaçanik, 29.03.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III (tretë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29 mars 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje kur u lexua evidenca, ishin 25 anëtarë, pas pak arriti anëtari Betim Shala, kështu që fillimisht në mbledhje ishin prezentë 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye Naim Beça. Në ndërkohë 6 anëtarë nga LVV e bojkotuan mbledhjen në të gjitha pikët: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Zahir Doda- DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Sali Malsiu-DSHM, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishte, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përhëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, me arsye mungon Naim Beça, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e III (tretë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, data 29 mars, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
3. Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;
5. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;
6. Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve;
7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;
8. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

z. Agim Mani: Para se të miratohet rendi i punës, po e ngriti një shqetësim. Në mbledhjen e kaluar, pos tjerash, është shqyrtuar edhe Raportin financiar Janar-Dhjetor për vitin 2023.

Përveç pasaktësive në shifra, raportit i mungojnë edhe tabelarët e shpenzimeve kapitale. Të gjitha pasaktësitë dhe të metat, ekzekutivi u mundua t'i arsyetoj si harresa, apo kinse të dhënat e tilla ishin në të njëjtin raport. Edhe një herë edhe tjetrën herë, ishin të pavërteta dhe një gjë e tillë nuk po ndodhë për herë të parë fatkeqësisht, sidomos me kërkesën e kryesuesit të KK u d akorduar që tabelarët e pasqyrave të shpenzimeve do t'na vijnë përmes postës elektronike ditëve në vijim. Pra, ne prisim raportin financiar të shpenzimeve kapitale, ndërkaq ju si ekzekutiv na dërgoni raportin financiar në fry balance. Fry balance është një shprehje për të treguar sa para keni në llogarinë tuaj, pa qenë të lidhur me ndonjë shërbim për ndonjë shpenzim të caktuar. Është një shumë e disponueshme që mund të përdoret sipas dëshirës. Të nderuar asambleistë, kjo është ajo që po e theksoj në vazhdimësi, ekzekutivi plotësisht po injoron dhe ofendon KK, duke dërguar çfarëdo dokumenti, apo shifre, duke aluduar në profesionalizmin e vet dhe në paaftësinë tonë. Kjo në të vërtetë është për të ardhur keq mënyra sesi ekzekutivi e trajton KK. A thua çka fshihet nga ky ekzekutiv, i cili thirret në transparencë? Ne konsiderojmë se do të ishte shumë e rëndësishme dhe profesionale të dërgoni definimin e projekteve kapitale dhe kualifikimin e shpenzimeve kapitale, tabelë standarde, si pjesë e raportit financiar e vitit 2023. Tabelarët për të cilët po flasim, përveç planifikimeve, shpenzimeve të mjeteve financiare të GQ apo të HVK të përmbledhura për vitin 2023, duhet të kenë, planifikimin, alokimin, shpenzimin, mbetjet e shumave financiare të projekteve kapitale për vitin 2023 sipas kategorive ekonomike dhe drejtorive komunale, të cilat përmbajnë edhe kodet funksionale. Ne e kemi kërkuar këtë raport e jo si e keni dërguar ju. Përveç kësaj, ju si ekzekutiv, përkatësisht kryetari, nuk iu përgjigjeni pyetjeve të anëtarëve të KK të seancës së 29 shkurtit 2024 dhe të mbledhjeve të mëhershme. Përderisa ju si ekzekutiv e injoroni opozitën dhe nuk jeni transparent ndaj qytetarëve, na bëni neve të parëndësishëm, atëherë ne si grup në shenjë pakënaqësie e bojkotojmë këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo ka pasur mundësi me u ngritur të pyetjet dhe kërkesat, megjithatë nuk ka problem. A doni me dëgjuar drejtorin e financave, që t'i jap fjalën ?

z. Bahri Selimi: Nëse doni me u sqaruar, unë jam i gatshëm, nëse nuk doni, ajo është çështje tjetër. Hapeni emailin, e keni dokumentin.

z. Agim Mani: Drejtorin e kisha dëgjuar, nëse shprehet si duhet, se unë nuk po rrej, por po flas në bazë të fakteve dhe argumenteve. Ne mund edhe të qëndrojmë në sallë, ju jeni këtu për me dhënë llogari qytetarëve, nuk i keni sjellë tabelarët, unë isha shumë i qetë dhe shumë i qartë.

Kryesuesi i Kuvendit: Mund të uleni e të debatojmë.

z. Adnan Reka: Nuk mund të debatojmë për derisa nuk na ofroni dokumentin, gabime po bëni në vazhdimësi.

Kryesuesi i Kuvendit: E ndërpresë debatin në mes drejtorit të financave dhe Agim Manit. Nëse jeni të interesuar me debatuar, debatojmë, nëse jo është çështje tjetër.

Me këtë rast, gjashtë (6) anëtarët nga Lëvizja Vetëvendosje- LVV i bojkotuan punimet e mbledhjes në të gjitha pikët: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma.

Me bojkotimin e seancës nga anëtarët e sipër cekur, në sallë janë prezentë. 20 anëtarë Kuorumi ekziston, mbledhja i vazhdoj me punimet. A ka kush diçka rreth rendit të punës, pyeti kryesuesi: Për diskutim nuk u paraqit kush tjetër, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 8 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni: Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së II (dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 29.02.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-4683/24.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: 1. Unë e kam një pyetje dhe shqetësim nga banorët e fshatit Runjevë, konkretisht lagjes "Ukmetaj", ku për fat punimet rreth rregullimit të kanalizimit kanë përfunduar, por që përfundimi i punimeve nuk është se ka sjellë rezultat të mirë për ato banorë, ngase kanalizimi nuk derdhët ne vendin e caktuar, por përshkon rrugën nën hekurudhë dhe derdhët ne rrugën "Migjeni".

2. Shqetësim tjetër i qytetarëve është edhe dëmtimet dhe përbaltja e rrugës "Besnik Begunca" nga kompania e cila po e bënë ndërtimin e hekurudhës. Pas përfundimit të punëve, a do t'i merr përsipër sanimet e rrugës kompania dhe komuna?

z. Agim Çaka: E kam një shqetësim të cilin e kam ngritur edhe në seancat tjera: Çështjen e hedhjes së mbeturinave në hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Idriz Seferi" pjesa kah Teqja dhe të Prroni i Çakëve. Kohëve të fundit e kam vërejtur se ka hedhje me të madhe të mbeturinave edhe me kamion apo traktor. Çka keni marrë në këtë drejtim, për këtë problematikë dhe a ka mundësi me vendosur shenjën "Ndalohej hedhja e mbeturinave" edhe pse dihet se, ndalohej hedhja e mbeturinave në hapësira publike gjithkund në botë, por me i potencuar edhe disa masa që mund të merren? A ka mundësi që ky fenomen me u ndal edhe me ndonjë foto të ndonjë qytetari, apo me ndonjë video dhe me sjellë këtu, në mënyrë që komuna me pas mundësi përmes inspektorëve me marrë masa? Unë mendoj se mundet me u bërë kjo dhe duhet me u bërë, sa me shpejt që është e mundur.

z. Betim Shala: Kam një pyetje për kryetarin, për çështjen e ndërtimit të rrugës "Sylejman Kuka" rrugë kjo që nuk i ka as 200m. Problemin siç e kam potencuar edhe me herët është kundërmimi nga era e kanalizimit është shumë i madh, me çka është problem me i lënë dritaret e hapura. Në vitin e kaluar është thënë se do të hynë në kuadër të projekteve të rrugëve lokale ky projekt.

znj. Ardita Rrahmani: Kryetar, e kam pa se keni formuar një komision komunal për regjistrimin e popullsisë, në përbërje prej 9 anëtarëve, ndërsa në bazë të rregullores komunat që kanë 30 mijë banorë, përbërja e komisionit duhet të jetë 7 anëtarë. Pse janë 2 anëtarë me tepër? Në komision është përfshirë edhe 1 anëtarë i OJQ. Në çfarë cilësie është ai anëtar i komisionit?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Po e ngiti një shqetësim të cilin e ngriti grupi i LVV që faktikisht nuk po i thonë të vërtetat, kur thanë se kryetari nuk po iu përgjigjet kërkesave të KK. Shumica e përgjigjeve gjithmonë janë dhënë përmes drejtorëve të drejtorive, se drejtorët janë këshilltarët e mi. Të dy përgjigjet janë kthyer nga drejtorët e drejtorive përkatëse, ndërkaq nëse

ata kërkojnë direkt përgjigje nga kryetari, ajo është çështje tjetër. Pyetjet kanë qenë direkt të lidhura me drejtoritë përkatëse, drejtorët kanë qenë të thirrur me iu përgjigjur në formë profesionale, kështu që thënie se nuk kanë marrë përgjigje, nuk qëndrojnë. Adnani e ka marrë sot përgjigjen, e ka marrë edhe herën e kaluar. Shqetësimi i tyre i vetëm është që ata me marrë përgjigjen direkt nga kryetari, mua po me duket kjo e paarsyeshme dhe me qëllim tendencioz.

Të pyetja e Arditës, drejtoresha është këtu, të gjitha veprimet e nevojshme i kemi bërë në bashkëpunim me ASK. Ata kanë vlerësuar cilët duhet me qenë dhe propozimet i kemi bërë se bashku me ta, dhe ata janë të thirrur për përbërjen e komisionit edhe për përfaqësimin në komision. Unë kam dashur me i kyçur të gjithë drejtorët, por ata kanë kërkuar se cilat drejtori përkatëse duhet me qenë të kyçur. Fjalën e keni për atë profesorin, por ai është i lëmit përkatëse dhe vetëm 2 ishin në Kosovë të asaj fushe. Ata kanë kërkuar me qenë në komision Avni Krasniqi dhe ne e kemi anëtarësua në komision.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

2. Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;

Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Fitore Vishi: Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Deshmoret e Lirisë', që sot e kemi për shqyrtim dhe aprovim, sipas meje dhe grupit të PDK i plotëson kushtet dhe standardet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si institucion kryesor shëndetësor në komunën tonë. Megjithatë, mendoj se numri i ekipeve të mjekësisë familjare do të duhej të shtohet. Nëse e kam kuptuar drejtë neni 6 pika 3, ekipi i mjekësisë familjare përbëhet nga 1 mjek dhe 2 infermiere familjare, ofron shërbim për dymijë banorë, që do të thotë se dymijë banorë presin shërbime mjekësore nga 1 mjek dhe 2 infermiere. Ndoshta do të ishte mirë që standardi i përcaktuar nga ministria përkatëse të rishqyrtohet dhe nga këtu të del një propozim me praktik. Ndoshta kjo do të ndikonte edhe në shtimin e numrit të mjekëve dhe infermierëve, në mjekësinë familjare si dhe frenimin sadopak të ikjes nga vendi të kuadrit shëndetësor nga komuna jonë, por dhe në shkallë republike. Ky është mendim personal i imi, ndërkaq si grup parlamentar i PDK ne e votojmë këtë draft statut.

z. Agim Çaka: Kërkoj të di, cilat janë ndryshimet që janë bërë në statutin e ri, arsyeja e ndryshimit të statuti, cilat kanë qenë pengesat që kanë penguar punën në QKMF, cila është çështja me e rëndësishme që e kemi në draft statutin e ri, që ka me ndikuar avancimin e punëve të suksesshme në QKMF?

z. Sali Malsiu: Pa i përket pyetjes se parë, 1 mjek në 2000 banorë, ministria e Shëndetësisë e ka hartuar këtë draft statut në bazë të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe Udhëzimit Administrativ 04/2020, i cili draft është unik për të gjitha komunat. Statuti i QKMF ka një rëndësi të madhe për organizimin dhe funksionimin e QKMF. Për këtë arsye, ne e kemi formuar grupin punues për hartimin e draft statudit, i cili grup ka bërë ndërhyrje aq sa ka pasur kompetencë, pasi draft statuti është unik për të gjitha komunat. Draft statuti ka qenë edhe në konsultim publik edhe në debate publike, e kemi marrë edhe pëlqimin e ministrisë, d.m.th. drafti i ka kaluar të gjitha procedurat. Pasi drafti është unik për të gjitha komunat, Udhëzimi administrativ i ministrisë e përcakton numrin e mjekëve dhe infermierëve për banorë, kështu ne nuk mundem me bërë ndryshime sesa mjek dhe infermierë me i pasur për banorë. Të pyetja e Agim Çaka, arsyeja pse është ndryshuar draft statuti, është se statuti ka qenë i bazuar në ligjin e ministrisë të vitit 2003, me ndryshimin e ligjit, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, është dashur me bërë ndryshimin e statudit se ligji është mbi statutin dhe është dashur me funksionuar me ligj. Ligji është i vitit 2013, ndryshimet që janë bërë prej statudit të kaluar, farmacisti i diplomuar, teknik farmacist, asistent i stomatologjisë, radiolog, teknik i biokimisë, specialist i preventivës, gjinekologu, kanë qenë vetëm specialistë konsulentë, ndërkaq tani

mundem me i marrë edhe me kontrata të brendshme. Sa i përket organizimit të QKMF me statutin e ri dhe UA 04/2020, organizohen departamente, siç janë: departamenti i mjekësisë familjare, i administratës, pastaj ndahen në sektorë dhe njësi, barnatorja qendrore e shumë të tjera që nuk kanë qenë me statutin e vjetër, tani me statutin e ri parashihen. Sa i përket ndryshimit që ne si komunë kemi munduar me i bërë, nuk kanë lejuar ndryshime, pasi donë me ruajtur formën unike për të gjitha komunat.

z. Agim Çaka: Sa i përket çështjes se farmacistit, nuk e kanë respektuar QKMF, nuk e di se a e kanë pasur në statutin e vjetër, por prej se ekziston ligji për produkte dhe pajisje medicinale, farmacisti duhet me qenë aty, pavarësisht se a është ordinancë shtetërore apo private, aty thuhet se farmacisti duhet me qenë në farmaci, se farmacisti merret me çështjen e barnave, se u tha që ka ndryshuar ligji, por këtu nuk besoj se ka ndryshuar ligji, por nuk është respektuar, ndërsa të statuti ka pasur mundësi mos me qenë i paraparë në statutin e vjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare/ Lënda: 01Nr. 60/01-6551/24.

3. Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Me një vendim të mëhershëm, është vendosur me u liruar pagesa e shërbimeve në QKMF për shkak të pandemisë. Tani ka ardhur propozimi me u shfuqizuar ai vendim, dhe me u kthyer pagesat sipas Rregullores për taksa dhe ngarkesa, që është në fuqi. Kjo ka qenë kërkesë e Arditës disa herë e edhe të kolegëve tjerë. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër Betim Shala, Abstenoj Raif Kasa. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.60/01-6552/24.

4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Çaka: Desha me pyetur, A kemi pasur këtë çështje në një mbledhje të KK, me të njëjtin person?

Kryesuesi i Kuvendit: I njëjti person ka qenë, por parcela është tjetër. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha/ Lënda: 01Nr.06-350/02-6583/24.

5. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për miratim këtë pikë dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre/ Lënda: 01Nr. 104/01-6738/24.

6. Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për miratim këtë pikë dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Subvencionim të fermerëve/Lënda: 01Nr.08-320/01-6741/24.

7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti tregon zbatimin e rekomandimeve që jepen nga auditorët, materialin e keni marrë, janë paraqitur zbatimi i rekomandimeve, e hapi diskutimin:

z. Rrustem Zenuni: Me vjen mirë që ekzekutivi i komunës ka qenë i përgjegjshëm në rekomandimet e dhëna dhe i ka zbatuar të gjitha, dhe këtë praktikë duhet vazhduar edhe tutje, që çdo herë të shkojmë një hap para. Kjo është një e arritur duhet të jetë në trendë në vazhdimësi.

znj. Ardita Rrahmani: Desha me marrë fjalën për 2-3 rekomandime, ku thuhet njëra është pjesërisht e zbatuar dhe tjetra e pazbatuar. Kërkojmë që për hera tjera të merrni veprimet e nevojshme për zbatimin e plotë të gjitha rekomandimeve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, raporti është sa për informim të KK. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022/ Lënda: 01Nr. 104/02-6750/24.

8. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Zyrtarja e KK e ka hartuar një raport përmbledhës, ku është paraqitur në vija të trasha aktiviteti i KPF në vitin 2023, duke u përmbledhur ato që janë me esenciale dhe kryesore. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Arovimin e Raportit të punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-6695/24.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:36. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 20 anëtarë, nga 26 anëtarë sa ishin prezentë në fillim të mbledhjes, pasi që 6 anëtarë nga LVV: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Bashkim Luma, bojkotuan punimet e mbledhjes në gjitha pikët.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu
Malsiu



Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e III (tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2024, mbajtur me 29.03.2024**

1. Kemal Murseli,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma,
4. Kadri Krivenjeva,
5. Fitore Vishi,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,
7. Edon Baftiu,
8. Selajdin Troni,
9. Fatmir Bunjaku,
10. Bashkim Krasniqi,
11. Florina Lika-Vishi,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani,
14. Kadrije Lika-Troni,
15. Adnan Reka,
16. Naim Beça,
17. Raif Kasa,
18. Ernesta Krasniqi,.....,
19. Bashkim Luma,
20. Arta Avdiu,
21. Ardita Rrahmani,
22. Besnik Salihu,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 22.04.2023

Për: Anëtarët e Kuvendit- znj. Ardita Rrahmani

Lënda: PËRGJIGJE


E nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të japim sqarime zyrtare lidhur me pyetjen/kërkesën tuaj, të parashtruar në mbledhjen Kuvendit të Komunës, më datë, **29.03.2024**, e cila ndërlidhet me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

znj. Ardita Rrahmani: 1. Unë e kam një pyetje dhe shqetësim nga banorët e fshatit Runjevë, konkretisht lagjes "Ukmetaj", ku për fat punimet rreth rregullimit të kanalizimit kanë përfunduar, por që përfundimi i punimeve nuk është se ka sjellë rezultat të mirë për ato banorë, ngase kanalizimi nuk derdhët ne vendin e caktuar, por përshkon rrugën nën hekurudhë dhe derdhët ne rrugën "Migjeni".

- *Përmes kontratës aktive "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" është punuar dhe funksionalizuar rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik në rrugën e "TMK-së" në segmentin Runjevë –Stagovë. Me këtë rast është bërë zgjidhja e duhur e trasesë dhe është sanuar defekti i mëparshëm shkaku i dëmtimit të gypit nga peshat e rënda në këtë segment rrugor.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!
Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtore i DSHPE-s